



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

PROCESVERBAL

**KONSULTIM PUBLIK MBI INFORMIMIN E QYTETARËVE PËR BUXHETIN E
VITIT 2025 DHE PLANIFIKIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2026 PËR BASHKINË
KAMËZ**

I mbajtur më 24.10.2025, në orën 16:00 , në dëgjesën me banorët e Bashkisë Kamëz, në lidhje me informimin e qytetarëve për buxhetin e vitit 2025 dhe planifikimin e buxhetit për vitin 2026. Takimi u zhvillua në Pallatin e Kulturës “Artan Cuku”.

Të pranishëm në takim ishin:

- Kryetari i Bashkisë së Kamëz, z. Rakip Suli;
- Administratorët e Njësive dhe Lagjeve Administrative të Bashkisë Kamëz;
- Këshilli Bashkiak
- Ndërlidhësit me komunitetin;
- Qytetarë të Kamzës.

Takimi u hap me fjalën përshëndetëse të administratores së Njesisë Administrative nr. 2, znj. Blerta Matraku, e cila, pasi falënderoi qytetarët për pjesëmarrjen, shprehu një falënderim të veçantë për Kryetarin e Bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli.

Më pas, fjalën e mori Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli, i cili falënderoi të pranishmit dhe u ndal te qëllimi i takimit. Në fjalën e tij, ai u shpreh:

“Jemi këtu jo vetëm për të prezantuar planifikimin e buxhetit për vitin 2026, por edhe për të paraqitur punët e kryera gjatë vitit 2025. Përpara qytetarëve duhet të jemi të qartë, të drejtpërdrejtë dhe transparentë. Gjatë këtyre pesë viteve, ne u kemi kthyer qytetarëve të Kamzës besimin tek bashkia. Ata e kanë ndjerë konkretisht punën dhe investimet e bëra, si edhe shërbimin e administratës ndaj tyre.

Nëse i referohemi betimit tim të vitit 2019, një nga prioritetet kryesore ishte infrastruktura arsimore. Së bashku arritëm të përfundojmë 44 objekte arsimore. Nuk u përqendruam vetëm te cilësia e ndërtimit, por edhe te arkitektura e objektit. Sot, me krenari mund të them se Bashkia Kamëz ka një infrastrukturë arsimore me standarde europiane dhe përbën një model për të gjitha bashkitë e vendit,” theksoi kryetari Suli.

Në vijim, z.Suli vuri në dukje arritjet e Bashkisë Kamëz në fusha të ndryshme të zhvillimit: “Gjatë këtyre pesë viteve, kemi punuar me përkushtim në infrastrukturë, arsim, politika sociale, ujësjellës e kanalizime, si dhe në krijimin e hapësirave rekreative për qytetarët. Një punë e tillë nuk ishte realizuar për më shumë se 30 vite. Sot, Kamza është shndërruar në një qytet modern dhe të zhvilluar, ku çdo banor ndjehet krenar të jetojë. Ne kemi arritur të zhdukim paragjykimet dhe ta kthejmë qytetin tonë në një model zhvillimi,” u shpreh z.Suli. Me pas, kryetari Suli u ndal tek punët e bëra në këto 5-vite.

Punët e bëra në këto 6-vite

❖ *Investimet 2019-2025, Bashkia Kamëz*

- Janë ndërtuar nga e para dhe rikonstruktuar 44 objekte arsimore, nga të cilat :
 - 20 shkolla
 - 19,229 nxënës
 - Me laboratore;
 - Sistem ngrohje dhe ftohje;
 - Ambjente sportive;
 - 17 kopshte
 - 7 çerdhe
 - 5572 fëmijë në kopshte dhe çerdhe

- Objekte arsimore të përfunduara në vitin 2025
 - Shkolla 9-vjeçare “Angela Merkel”

- Kopshti “Engjejt” Babrru Qendër
 - Kopshti dhe çerdhja “Univers” Laknas
 - Rikonstruksion fushat sportive shkolla “100 Vjetori”
 - Rikonstruksion shkolla “Dom Nikoll Kaçorri” Babrru
-
- Kanalizime 301 km
 - Ujësjiellës 406 km
 - Sistemi online për faturat
 - Rritja e aboneve nga 16.700 në 32.500
 - Pastrimi i Qytetit
 - Pastrimi i qytetit që nga 28 marsi 2024 menaxhohet nga bashkia
 - Blerja e mjeteve të pastrimit
 - Ekiye të pastrimit të mirëorganizuara
 - Stacioni Zjarrëfikës
 - Tre zjarrëfikse
 - Autoshkalla
 - Uniformat ë reja
 - Për çdo familje që i është djegur shtëpia që nga viti 2013 është dëmshpërblyer nga bashkia.
 - Rindërtimi Valias
 - 19 Pallate
 - 270 apartamente
 - Rindërtimi nga tërmeti : 426 banesa individuale
 - Rehabilitimi i pallateve
 - Qendër Kamëz - 32 pallate/ 490 familje përfitues
 - Babrru Qendër – 16 pallate/ 250 familje përfituese
 - Paskuqan, 2 pallate/22 familje përfituese
 - Laknas, 4 pallate/69 familje përfituese
 - Shëtitorja e Bathores, me gjatësi 1 km.
 - Shëtitorja e Frutikulturës

- Gjatësia 1.3 Km
 - Përfitojnë 20,000 banorë
- Parku i Liqenit të Paskuqanit

Kanë përfunduar:

- Pedonalja 5.1 km
- 2 Parkime në të dy krahët
- 62,000 pemë të mbjella
- Amfiteatri
- Moli
- Kanalizimet

❖ *Infrastrukturë rrugore*

- 2019-2024 Infrastrukturë rrugore të përfunduara 235.6 km
- Në Lagjen Nr.1, përfunduar 51.4 km rrugë;
 - Në Lagjen Nr.2, përfunduar 48,5 km rrugë;
 - Në Lagjen Bathore, përfunduar 55,3 km rrugë;
 - Në Njësinë Paskuqan, përfunduar 80,4 km rrugë;

❖ *Të Rinjtë*

- 640 studentë kanë përfituar bursa ekselence, për rezultate të larta në mesime.
- Nga klasa 5-9, marrin 270\$ në vit dhe
 - Nga klasa 10-12, marrin 450\$ në vit
- 162 ekiye sportive , me 1550 të rinj të aktivizuar në sporte të ndryshme.
- Panairi i Librit “Kamza Lexon”.
- Klubi i Librit.
- Konkurse artistike për të rinjtë.
- Këshilli Rinor.
- Praktika Pune.

- Karta e studentit.

❖ ***Taksa dhe Tarifa vendore***

- Nga 1 janari sistemi online i taksave
- Për çdo biznes të ri që hapet në Bashkinë Kamëz vitin e parë përjashtohet nga taksa.
- Ulja e tarifave dhe taksave me 60 % për biznesin e vogël
- Taksat familjare: Lehtësira dhe përjashtime të taksave dhe tarifave familjare për kategoritë në nevojë:
 - Invalid
 - Kryefamiljare Gra
 - Pensionistët e vetmuar
 - Familje që jetojnë në emigracion
 - Familje që trajtohen me ndihmë ekonomike

❖ ***Politikat Ekonomike Sociale 2025***

- 2.3 milion buxheti për programet sociale.
- 258 familje trajtohen me bonus qeraje nga strehimi social .
- 180 familje të prekura nga unaza e madhe trajtohen me bonus qiraje
- 5000 lekë/muaj fëmijët me status jetim.
- 5000lekë/muaj për të moshuarit të vetmuar
- 530 fëmijë të familjeve në nevojë, marrin ushqim falas
- 70 fëmijë trajtohen tek Qendra Multifunksionale
- 64 Shërbim lëvizës për personat me aftësi të kufizuara (logopedi, fizioterapi, psikologji)
- 500 përfitues Transport pa pagesë familjet vulnerabel, personat me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës në familje dhe të moshuarit

- 68 familje- kredi të butë
 - 2 antarë në familje -> 3,440,250 lekë
 - 3-4 anëtarë në familje -> 5,066,550
 - 5 anëtarë dhe më shumë -> 6,255,000
- Punësimi i personave me aftësi ndryshe.

❖ Investime në proces për vitin 2025

- Stadiumi Valias
- Godina e Bashkisë Kamëz
 - 3000m²
 - Sheshi 13,000 m²
 - Parkim nëntokësor
- Parku i Liqenit të Paskuqanit
 - Terrene Sportive
 - Kënde lojrash
- Objekte arsimore në proces për vitin 2025
 - Gjimnazi “Sulejman Elezi” Laknas
 - Kopshti Qendër Kamëz
- Për vitin 2025 janë në proces, 79.03 km rrugë ku:
 - Në Lagjen Nr.1, janë në proces 19.8 km, 122 rrugë;
 - ✓ Blloku Lagjia Lura – 11 km – 100%
 - ✓ Blloku Laknas- Valias - 4.8 km
 - Në Lagjen Nr.2, janë në proces 14.4km, 92 rrugë;
 - ✓ Blloku Kamez – 3.45 km
 - ✓ Blloku Frutikulturë – 6 km
 - Në Lagjen Bathore, janë në proces 16.63 km, 208 rrugë;

- ✓ Lagjia Nr. 1 dhe 5 -> 11.6 km
- ✓ Lagjia Nr. 5 dhe 7 -> 5.1 km
- Në Njësinë Paskuqan, janë në proces 21.52km, 131 rrugë;
 - ✓ Blloku Paskuqan 1 -> 5.9 km
 - ✓ Blloku Paskuqan 2 -> 4.25 km
 - ✓ Blloku Babrru -> 8.93 km
 - ✓ Blloku pingul me rrugën Betim Muço dhe rrugicat Paskuqan 1 dhe 2 – 2.41 km
- 7.5 km riasfaltime për vitin 2025
 - ✓ Rruga “Beslidhja”
 - ✓ Rruga “Dajti”
 - ✓ Rruga “Azem Hajdari”
 - ✓ Rruga “Konferenca e Mukjes”
 - ✓ Rruga “Rilindja”

❖ **Investimet infrastrukturore të planifikuara për vitin 2026, 84 km (321 rrugë)**

- Lagjia Nr.1 - 18.8 km (123 rrugë)
- Lagjia Nr.2, - 23.9 km (94 rrugë)
- Njësia Paskuqan, - 30 km (80 rrugë)
- Lagjia Bathore, - 6 km (24 rrugë)

❖ **Paketa fiskale për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2026**

Gjatë dëgjeses publike u diskutu dhe paketa fiskale për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2026, ku u theksua se niveli i taksave dhe tarifave vendore mbetet i pandryshuar, me synimin ruajtjen e stabilitetit fiskal.

Gjatë takimit, çdo pjesëmarrësi iu dha mundësia dhe koha e nevojshme për të shtruar pyetje dhe për të dhënë sugjerime lidhur me planifikimin e buxhetit për vitin 2026.

Takimi u mbyll me falënderimin e përzemërt të kryetarit Suli, i cili siguroi të pranishmit se çdo mendim dhe propozim i tyre do të merret në konsideratë në procesin e hartimit të buxhetit 2026.







